



BASHKIA FUSHË - ARRËZ

Nr. 561 prot. Dt. 24.02.25

Ref: Këshilli Bashkiak

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.24/1prot.

Shkodër, më 17.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz Nr.4, datë 27.01.2025.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB Nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 24, neni 54/n, neni 55/2, neni 64 germa c, shqyrtoi Vendimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz Nr.4, datë 27.01.2025 "Për përcaktim të çmimit të qerasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg për efekt të subvencionit të qerasë në bashkinë Fushë Arrëz për 2025".

Pas analizimit të dokumentacionit në tërësi, Prefekti kërkon rishqyrtim të vendimit duke bërë plotësim të aktit edhe për zonat rurale në territorin e bashkisë Fushë Arrëz, në zbatim të nenit 38 të ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social", i përditësuar, pika 4/a e VKM Nr.362/2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qerasë në treg të lirë.....", kjo në respekt të parimit të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

